



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2020:189197

Datë: 25.01.2024

Numri i dokumentit: 05238775

**AA.nr.323/2023**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar i kolegjit, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti, anëtar, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit M... E..., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson U.. V..., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme-Komisioni i Ankesave për të Huajt, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të paditësit avokat U... V..., nga Prishtina, të ushtruar, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.2298/2020, të datës 28.02.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 09.01.2024, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. APROVOHET** si e bazuar ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditësit avokat U... V..., nga Prishtina.
- II. NDRYSHOHET** Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.2298/2020, i datës 28.02.2023.
- III. ANULOHET** vendimi i të paditurës, Qeveria e Republikës së Kosovës - Komisioni i Ankesave për të Huajt në Prishtinë me nr. Ref. 87/2020 i datës 11.08.2020.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin e ankimuar, në pikën I të dispozitivit ka vendosur: REFUZHET si e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit M... E..., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson U... V..., avokat nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi nr.87/2020 i datës 11.08.2020 i Komisionit të Ankesave për të Huajt. Në pikën II të aktgjykimit ka vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesi i autorizuar i paditësit avokat U... V..., nga Prishtina ka ushtruar ankesë, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të shkeljeve të dispozitave

të procedurës, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Në mes tjerash thekson se e paditura vendimin për urdhër largim me forcë e ka mbështetur në nenin 6 të Ligjit për të Huajt e cila dispozite sqaron çështjen e revokimit të leje qëndrimit e cila është në procedurë të veçante dhe nuk është objekt i trajtimit nga Komisionit të Ankesave për të Huajt. Objekt i shqyrtimit pranë gjykatës së shkallës së parë ka qenë vendimi i Komisionit të Ankesave nr. Ref. 87/2020 i cili është nxjerr nga ky organ në rivendosje sipas ankesës së paditësit ndaj vendimit për urdhër largim me forcë. Ndërsa organi administrativ Komisioni i Ankesave ka vendosur ta refuzoj ankesën duke u mbështetur në dispozitat ligjore të Ligjit për të Huajt të cilat rregullojnë çështjen e leje qëndrimit, e të cilat janë dy çështje të ndryshme dhe rregullohen me dispozita të ndryshme. Me tej thekson së lidhur me çështje të njëjta si në rastin konkret, gjykatat e të gjitha instancave të Republikës së Kosovës kanë vepruar ndryshe, përkatësisht kanë aprovuar kërkesëpadinë e paditësve, duke i anuluar vendimet e Komisionit të Ankesave të nxjerra sipas ankesës mbi vendimet për urdhër largim me forcë. Andaj rrjedhimisht rezulton se vendimet e të paditurës të komisionit të ankesave për të huaj Nr. ref. 87/2020 i ka rënë baza mbi të cilën është nxjerrë. Me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e paditësit M... E... dhe të ndryshohet aktgjykimin i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.2298/2020, i datës 28.02.2023, ashtu që të anulohet vendimi nr.87/2020 i datës 11.08.2020 i Komisionit të Ankesave për të Huajt.

Gjykata e Apelit, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimimit të kontestuar në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konflikte Administrative,(LKA), dhe nenit 194 të LPK-së, ligj i aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, në drejtim të thënieve në ankesën e paraqitur, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

#### **Ankesa është e bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Qeveria e Kosovës – Komisioni i Ankesave për të Huajt në Prishtinë, me vendimin me nr.87/2020 të datës 11.08.2020, e ka refuzuar ankesën e datës 16.04.2018, me numër të protokollit 24/2018 të z. M... E..., i lindur me datën 06.01.1974 në Karacabey, Republika e Turqisë, me nr. të pasaportit: BI 9369082, të parashtuar nga z. U... V..., avokat nga Prishtina, sipas autorizimit të palës, kundër vendimit për Urdhër Largim me Forcë me nr. Ref.44/2018 të datës 29.03.2018, të lëshuar nga Drejtoria për Migrim dhe të Huaj (DMH) në Policinë e Kosovës. Ndërsa është mbetur në fuqi Urdhër Largimi me Forcë me nr. Ref. 43/2018 i dt.29.03.2018, të lëshuar nga Drejtoria për Migrim dhe të Huaj në Policinë e Kosovës. Kurse Urdhër Largimi me Forcë me nr. Ref. 43/2018 i dt.29.03.2018 dhe masa e ndalimit të hyrjes në territorin e Republikës së Kosovës në kohëzgjatje prej pesë (5) vitesh, është zvogëluar në tre (3) vite ndalim të hyrjes në territorin e Republikës së Kosovës.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Qeveria e Kosovës – Komisioni i Ankesave për të Huajt në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 29.12.2020, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i pa ligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit të paraqitur kundër vendimit me nr.87/2020 të datës 11.08.2020, të paditurës Qeveria e Kosovës – Komisioni i Ankesave për të Huajt në Prishtinë, si dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin e ka refuzuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Me arsyetim se vendimi i kundërshtuar me padi është marrë konform të gjitha dispozitave procedurale dhe ligjore në fuqi dhe se pretendimet se ekziston vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, nuk qëndrojnë. Gjykata e shkallës së parë konstatoi se procedura

administrative e zhvilluar tek organi i paditur është kryer në përputhje të plotë me nenin 132 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Gjykata e shkallës së parë po ashtu konstatoi se vendimi i të paditurit nuk është në kundërshtim me nenin 48 të LPPA-së, për faktin që nga vlerësimi dhe analizimi i pjesës arsyetuese, gjykata erdhi në përfundim se në pjesën arsyetuese janë dhënë sqarime të detajuara edhe të dispozitave ligjore mbi të cilat është marrë vendimin i kundërshtuar me padi. Në këtë drejtim, gjykata e shkallës së parë gjeti se vendimi i atakuar i marrë nga i padituri është në përputhje të plotë me nenin 47, paragrafin të LPPA-së. Gjykata e shkallës së parë refuzoi pretendimet e paditësit se e paditura nuk ka marrë për bazë vërejtjet e Gjykatës dhe të njëjtat i cilësoi si të paargumentuara për faktin që asnjëra nga këto pretendime nuk është mbështetur as në ligjin material por as edhe në gjendje faktike.

Gjykata e shkallës së parë gjithashtu gjeti se e paditura me të drejtë ka zbatuar nenin 6 të Ligjit për të Huajt. Mbi bazë të kësaj, gjykata gjeti se është tërësisht në diskrecion të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës që në bazë të informatave me të cilat ka disponuar e të cilat ndërlidhen me rastin në fjalë, të konstatoj se një individ përbën rrezik për sigurinë shtetërore, për këtë të njoftoj organet kompetente të të paditurës, dhe e paditura, konform bazës ligjore të sipërpërmendur, të ndërmarr masat e duhura konform obligimeve ligjore. Në këtë drejtim, gjykata gjeti se në rastin konkret, nuk ka qenë e domosdoshme që me rastin e marrjes së vendimit të kontestuar me padi, por edhe akteve tjera që i kanë paraprirë nxjerrjes së aktit përfundimtar administrativ, të paraqiten të dhëna të detajuara, publikimi i së cilave do të shkelte sekretin shtetëror dhe do të pengonte punën e organeve shtetërore të inteligjencës. Mbi këto arsye thënie të paditësit në padi nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike, nga ajo e vërtetuar nga e paditura.

Kolegji i Gjykatës së Apelit duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes duke ekzaminuar aktgjykimin e ankimuar, shkresat e lëndës edhe sipas pretendimeve ankimore gjen se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika n), dhe neni 183 e 184 të LPK-së, se është juridikisht i pa qartë, kundërrthënës me vetveten dhe arsyetimin e tij, po ashtu i njëjti është jo i plotë lidhur në vërtetimin e gjendjes faktike dhe me shkelje të së drejtës materiale. Kolegji i kësaj gjykate duke e vlerësuar pretendimet ankimore të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit avokat U... V..., nga Prishtina për shkeljet ligjore të lartcekura, konsideron se ankesa është e bazuar. Ngase vendimi i kontestuar del se përmban të meta të tillë për shkak të të cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij. Meqë, në rastin e nxjerrjes së urdhërit për largimin me forcë të paditësit, vërehet se e paditura ka vepruar në kundërshtim me nenin 16 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të LKA, pasi nuk ka aplikuar fare ose nuk ka aplikuar drejt dispozitat ligjore, duke qenë se kishte aplikuar dispozitat e nenit 6 të Ligjit për të Huajt që kanë të bëjnë me refuzimin apo revokimin e leje qëndrimit për rrethanat të sigurisë shtetërore, dhe dispozitën e nenit 99 paragrafi 2 e të njëjtit ligj e cila dispozitë parasheh procedurat e zbatimit të urdhërit të dëbimit në rast se prania e të huajt përbën kërcënim për rendin dhe sigurinë shtetërore, ndërsa urdhëri për largim me forcë duhet të kishte për bazë dispozitën e nenit 97 të Ligjit për të Huajt në të cilën dispozitë janë paraparë kushtet dhe procedurat të cilat duhet ndjekur për të zbatuar një urdhër të tillë, e që në rastin konkret nuk vërehet se janë marr për bazë kushtet dhe kriteret e tilla nga e paditura me rastin e lëshimit të këtij urdhëri. Në anën tjetër e paditura në arsyetimin e urdhërit të dhënë kishte theksuar *“bazuar në dëshmitë e bazuar nga institucionet kompetente të sigurisë, konsiderojmë se janë përmbushur kushtet ligjore për largim me forcë nga territori i Republikës së Kosovës me dt.29.03.2018 për shtetasin e huaj, për shkak se qëndrimi i tij i mëtejshëm mund të paraqet kërcënim që lidhet me sigurinë shtetërore dhe rendin publik”*. Një arsyetim i tillë në formë supozimi del i pa bazuar dhe kjo nga fakti se nëse qëndrimi i paditësit do të paraqiste kërcënim që lidhet me sigurinë dhe rendin shtetëror kjo duhej të vërtetohej nga e paditura, dhe kjo nuk është vërtetua me asnjë provë as në procedurën e zhvilluar nga organi administrativ e as

nga provat e administruara në seancën e shqyrtimit gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë. Prandaj mbi këtë bazë është i bazuar edhe pretendimi i përfaqësuesit të paditësit se e paditura ka vepruar në kundërshtim me nenin 16 paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 të LKA, pasi që nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike, apo nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike. Mbi arsyet e njëjta nuk mund të shqyrtohet edhe ligjshmëria e vendimi i të paditurës me nr. Ref. 87/2020 i datës 11.08.2020 me të cilën refuzohet ankesa kundër vendimit për Urdhër Largim me Forcë me nr. Ref.44/2018 të datës 29.03.2018, të lëshuar nga Drejtoria për Migrim dhe të Huaj (DMH) në Policinë e Kosovës. Kështu e paditur në asnjërin akt të kontestuar dhe as në gjykatën e shkallës së parë nuk kishte dëshmuar se ka zbatuar dispozitat e Ligjit për të huajt, që kanë të bëjnë me largim e të huajit me forcë nga territori i Republikës së Kosovës, ndërsa në anën tjetër nuk ka provuar se qëndrimi i paditësit në territorin e Republikës së Kosovës paraqet rrezik për rendin dhe sigurinë shtetërore. Prandaj mbi këto arsye kolegji i kesaj gjykata vlerëson së vendimi i kontestuar i të paditurës është i kundërligjshëm dhe si të till anulohet.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, në kuptim të nenit 46.3 dhe 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, dhe nenit 195 paragrafi 1 pika e) e lidhur me nenin 201 paragrafi 1 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – PRISHTINË**  
**AA.nr.323/2023, me dt.09.01.2024**

**Kryetar i kolegjit,**  
**Ramiz Kuqi**